



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 93/2012
Prishtinë, më 29.1.2013, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha – Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi Myzejene Selmani, dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Berat Buzhala dhe Visar Ymeri.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi-, ZPRK; Burim Ejupi dhe Darsei Canhasi, INDEP; Visar Rushiti, GAP; Arbëresha Loxha, Grupi për Studime Politike dhe Juridike, Sylejman Blaku, “Kosova Sot”, gazetar; Kushtrim Ahmeti, “KTV”, gazetarë dhe Teuta Gashi, “Kosova Press”, gazetarë.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22.1.2013;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-189, për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve;
4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr. 04/L-159, për Zonat ekonomike;
5. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2013;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22.1.2013

Procesverbali nga mbledhja e datës 22.1.2013 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-189, për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve

Kryetari – Tha se sipas Rregullores së Kuvendit, para leximit të parë, duhet ta shqyrtojmë në parim këtë projektligj, duke kërkuar nga deputetët që të paraqesin vërejtjet e tyre në parim, pastaj të formohen grupet punuese për t'i shqyrtuar dhe nxjerr amendamentet.

Pas debatit, Komisionit nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-189 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-189, për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve.

Grupi punues për shqyrtimin e këtij projektligji, ka këtë përbërje: Teuta Sahatqija, raportuese, Ramiz Kelmendi dhe Zenun Pajaziti.

3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr. 04/L-159 për Zonat ekonomike

Kryetari – Theksoi pas që kjo pikë e rendit të ditës është shqyrtuar dhe në mbledhjen e kaluar, por ka mbetur të definohet *Amendamenti 27*, të dispozita ndëshkuese, lidhur me gjobat. Dhe, ne kemi një propozim, ku është caktuar shuma e gjobës në minimum dhe maksimum prej 3.000 deri 10.000 euro për personat juridikë. Pastaj e hapi debatin.

Myzejene Selmani – Propozoj që shuma minimale të ulet prej 3.000 në 2.000 euro dhe ajo maksimale të mbetet 10.000 euro.

Hashim Deshishku – Tha që pajtohet me znj. Selmani që të ulen gjobat që mos t'i dëmtojmë bizneset më anë të ligjeve, por ato biznese që nuk i respektojnë ligjet atëherë të kemi bazën ligjore që të gjobiten.

Ramiz Kelmendi - Kërkoj që gjatë miratimit të ligjeve të ketë një kujdes më të madh, kur është fjala për bizneset, që mos të largohen për shkak të gjobave të mëdha që mund të jenë në ligje, sepse ne, mund ti dëmtojmë jo vetëm personat juridikë, por dhe të punësuarit nëpër biznese. Ai propozoi që dënimi të jetë nga 1.000 deri në 3.000 euro.

Sala Berisha - Shala - Tha që pajtohet që të zvogëlohen gjobat, për arsye që t'ju japim mundësi investorëve të huaj të investojnë, pastaj nëse bizneset nuk respektojnë ligjin mund t'i sanksionojmë me anë të ligjit.

Teuta Sahatqija - Tha që në amendamentin 27, te dispozita ndëshkuese behët fjalë vetëm për zonat ekonomike e jo për ndonjë proces tjetër. Ajo theksoj së pajtohet me propozimin për zvogëlimin e gjobës në minimum prej 2.000 euro.

Kryetari- Sqaroi se për dispozita ndëshkuese, të nenit 23, nuk është që e dëmton biznesin, por procesi i sanksionimit duhet të jetë për ato biznese, në rast që nuk e respektojnë ligjin.

Propozimi i deputetes Selmani u përkrah nga Komisioni.

Pas debatit më shtatë (7) vota Për, një (1) votë Kundër, Komisionit nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me Rekomandime për Projektligjin Nr .04/L-159, për Zonat ekonomike

Dhe, Kuvendit i paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet Raporti me Rekomandime për Projektligjin Nr. 04/L-159, për Zonat ekonomike

5. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2013

Kryetari - Tha që stafi i komisionit e ka përgatitur një draft të planit të punës, në bashkëpunim me INDEP, duke u bazuar në programin legjislativ të Qeverisë, prandaj, dhe ne, si komision edhe në vitin e kaluar jemi vlerësuar lartë për punën tonë nga monitoruesit e punës së Kuvendit. Pastaj e hapi debatin.

Sala Berisha-Shala - Propozoj që koha e raportimeve të Agjencive të Pavarura, të jetë në përputhje më kushtetutë, ashtu siç është paraparë në muajin mars. Dhe, propozoj që të marrim iniciativën për hartimin e projektligjit për shërbimet gjeologjike.

Myzejene Selmani – Kërkoj që të fshihet nga drafti i planit të punës për vitin 2013, monitorimi i Ligjit për Partneritet publiko-privat, pasi që ky ligji është në kompetencën e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Te organizimi i konferencave, propozoj që të organizohet një konferencë me investorët e huaj, për të parë mundësinë e investimeve të jashtme në zhvillimin ekonomik të vendit.

Kryetari - Tha që po e fusim në planin e punës, që të organizohet një konferencë në lidhje me Strategjinë e Energjisë 2009 - 2018. Po ashtu në muajin prill që të bëhet monitorim i ligjit për masat mbrojtëse.

Pas debatit, Komisioni njëzëri nxori këtë

V E N D I M

1. *Miratohet Plani i Punës së Komisionit për vitin 2013.*
2. *Plani buxhetor i Komisionit i bashkëngjitet si aneks Planit të Punës së Komisionit për vitin 2013.*

6. Të ndryshme

Çështje vijuese

Kryetari – I njoftojë deputetët e Komisionit lidhur më dy ftesa që kanë ardhur për organizimin e konferencave, kur është ftuar Komisioni të marrë pjesë, njëra është e organizuar nga Organizata gjermane GIZ-i, më temën për “Transportin”, që mbahet prej 31 janarit, deri më 3 shkurt në Durrës. Ndërsa, ftesa tjetër, është nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Shqipëri, për temën “Marrëdhëniet Ekonomike Kosovë – Shqipëri, sot dhe nesër”, që do të mbahet më 6 shkurt 2013, në Tiranë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit